



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT
ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE



RAPORT

MBI SITUATËN E RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT

NË SHQIPËRI PËR VITIN 2017

**RAPORT MBI SITUATËN E RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE
DHE LIRIVE TË NJERIUT**

NË SHQIPËRI

PËR VITIN 2017

Tiranë, Mars 2018

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Përmirësimi i situatës të të drejtave të njeriut në Shqipëri nëpërmjet forcimit të shtetit të së drejtës – Klinika ligjore XI”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe mbështetur financiarisht nga organizata Civil Rights Defenders, me fonde të Qeverisë së Mbretërisë Suedeze.



Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk reflekton qëndrimin e Qeverisë Suedeze ose të organizatës Civil Rights Defenders

Përgatitën:

1. Elton Frashëri, Avokat pranë KShH-së

Rishikuan:

1. Z. Niazi Jaho, Këshilltar Ligjor pranë KShH-së
2. Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive e KShH-së

Redaktoi: Klaudia Malaj

Përktheu: Guri Lekloti

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: ©Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr. Brigada e VIII-te, Pallati “Tekno Projekt”
Shk. 2 Ap. 10, Tirana-Albania
Kutia Postare nr.1752
Tel: 04 2233671
Cel: 0694075732
E-mail: office@ahc.org.al;
Web site: www.ahc.org.al

I/E dashur lexues/e,

Viti 2017 shënoi sfida dhe zhvillime të rëndësishme për situatën e të drejtave të njeriut dhe shtetin e së drejtës, çka reflektoi edhe në veprimtarinë voluminoze, me peshë dhe përgjegjësi të Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KSHH-së).

Raporti vjetor mbi respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Shqipëri për vitin 2017¹ synon informimin e publikut, institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare të akredituara në vendin tonë, si dhe rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së organeve publike për forcimin e kulturës së ligjshmërisë dhe përmirësimin e veprimtarisë së tyre për një mbrojtje dhe respektim më të mirë të të drejtave themelore të njeriut.

Kontributi modest i organizatës tonë gjatë 2017-ës, është orientuar drejt cilësisë dhe impaktit konkret për njerëzit duke pasur kryesisht fokusin në monitorimin e fillesave të zbatimit të reformës në drejtësi, zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të qershorit, ofrimit të oponencës ligjore në procesin ligjbërës, ndjekjes dhe përfaqësimit të rasteve në gjykatat vendase, Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, monitorimit proaktiv të respektimit të të drejtave të njeriut nga organet e administratës publike dhe sistemit gjyqësor, kryerjes së studimeve kërkimore dhe hartimit të raporteve studimore, realizimin e veprimtarive të edukimit ligjor dhe parandalimit të fenomeneve të dëmshme për shoqërinë sikurse është ekstremizmi i dhunshëm, kontributin me raporte hije për organizata ndërkombëtare si Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës dhe Komiteti për Parandalimin e Torturës, etj.

Gjatë vitit 2017, aktiviteti i KSHH-së ka pasur në vëmendje një larmishmëri fushash, si fushën e drejtësisë, luftën kundër korrupsionit, sistemin e burgjeve, pikat e kalim kufirit dhe institucionet ku mbahen emigrantet e parregullt dhe qendrat e azilantëve, transparencën e institucioneve, konsultimin e grupeve të interesit në procese vendimmarrëse, mbrojtjen nga ekstremizmi i dhunshëm, radikalizmi, diskriminimi, lirinë e shprehjes dhe median e lirë, mirëqeverisjen në nivel qendror dhe vendor, respektimin e të drejtave dhe lirive për grupet në nevojë, mbrojtjen e mjedisit, zgjedhjet e lira dhe të ndershme, etj.

Forca reaguese dhe natyra proaktive e veprimtarisë së KSHH-së ka vijuar të ndihet në opinionin publik, falë mbulimit në median e shkruar dhe elektronike, aktivizmit të shtuar në median sociale dhe shtrirjes së veprimtarisë së organizatës në zona të ndryshme të vendit.

Gjej rastin të shpreh mirënjohjen e thellë dhe të falënderoj për mbështetjen e dhënë për realizimin e veprimtarisë së KSHH-së gjatë vitit 2017, Asamblenë dhe Bordin vendimmarrës të organizatës, stafin ekzekutiv, konsulentët e jashtëm dhe vëzhguesit e përkushtuar dhe të palodhur, organizatat partnere, Komitetet e Helsinkit simotra në rajon dhe më gjerë, donatorët që kanë mbështetur financiarisht veprimtaritë e organizatës, përkatësisht Civil Rights Defenders, Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Ambasadën e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta, Ambasadën Britanike, Delegacionin e Bashkimit Evropian në vendin tonë, Open Society Institute, Projektin e USAID “Drejtësi për të Gjithë”, European Roma Right Center.

Sinqerisht,

Erida Skëndaj

Drejtoresh Ekzekutive

¹ Gjetjet kanë rezultuar nga informacioni i siguruar deri në fund të muajit Dhjetor 2017

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	5
CJETJET KRYESORE.....	9
1.1 E DREJTA E JETËS DHE SHËNDETIT	9
1.2 E DREJTA PËR TË ZGJEDHUR E PËR T'U ZGJEDHUR	10
1.3 E DREJTA E PRONËS.....	10
1.4 LIRIA E MEDIAS.....	11
1.5 DREJTËSIA.....	12
1.6 TË DREJTAT E PERSONAVE ME LIRI TË KUFIZUAR.....	17
1.7 LUFTA NDAJ EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM, BARAZIA DHE NDALIMI I DISKRIMINIMIT	21
1.8 E DREJTA PËR T'U KONSULTUAR DHE INFORMUAR.....	23
1.9 MBROJTA E MJEDISIT	24

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë vitit 2017 janë vërejtur vonesa në ngritjen dhe funksionimin e institucioneve të reja të sistemit drejtësisë. Në këtë drejtim ka ndikuar negativisht polarizimi i situatës politike në vend, ankimi i ligjit të vettingut në Gjykatën Kushtetuese si dhe çështje të tjera të natyrës organizative.

Në përzgjedhjen e anëtarëve në organet e vettingut, vëzhguesit e KShH-së vërejtën elementë të formalizmit, për shkak të mungesës së një pjese të anëtarëve të komisioneve *ad hoc* parlamentare apo të indiferencës së treguar prej tyre gjatë seancës dëgjimore. Një numër i lartë kandidatësh për këto organe nuk u përzgjedhën, edhe pse arsimi dhe përvoja e tyre në vendet perëndimore ishin të vlerësueshme. Kriteret e forta kushtetuese dhe ligjore ishin një tjetër pengesë në këtë drejtim.

Gjatë 2017-ës, Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK), Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), Prokuroria e Përgjithshme dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk treguan transparencë të plotë dhe brenda afateve ligjore, për dhënien e informacionit statistikor që ka rezultuar nga veprimtaria e tyre si organe ndihmëse të vettingut për tri komponentët e tij, *aftësitë profesionale, integritetin dhe pasurinë e gjyqtarëve dhe të prokurorëve*. Për këtë arsye, KShH ju drejtua me ankim Komisionerit për të Drejtën e Informimit, i cili në muajin Shkurt të vitit 2018 konstatoi cenim të së drejtës për informacion nga DSIK, ILDKPKI. Mungesa e transparencës ndaj publikut vlerësojmë se nuk ndikon pozitivisht në besimin që njerëzit duhet të kenë tek procesi i vettingut.

Vonesa janë vërejtur në ngritjen e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, si Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe i Prokurorisë (*KLP dhe KLGJ*), si dhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi të cilat kanë ndikuar në mosplotësimin e vakancave në Gjykatën e Lartë, në emërimin e Prokurorit të Përgjithshëm me mandat të plotë, si dhe në mos ngritjen në kohë të strukturave të specializuara anti-korrupsion. Përzgjedhja me short e kandidatëve jo gjyqtarë dhe jo prokurorë për KLGJ-në dhe KLP-në, në mungesë të konsensusit mes anëtarëve të nën komisionit parlamentar, edhe pse një mënyrë për ta zhbllokuar procesin, vlerësojmë se nuk garantoj plotësisht zgjedhjen e anëtarëve të këtyre organeve, mbi bazë merite dhe integriteti.

Lufta kundër korrupsionit kërkon angazhim serioz të institucioneve të specializuara ligjzbatuese rritjen e gjurmimit, zbulimit, ndjekjes dhe ndëshkimit penal të autorëve të këtyre veprave, pa asnjë dallim për shkak të statusit apo pozitës zyrtare. Besimi i qytetarëve në këtë luftë vijon të jetë në nivele të ulëta. Ankesat e tyre evidentojnë se korrupsioni vijon të minojë mirëqenien dhe lulëzimin ekonomik të vendit, duke prekur veçanërisht shtresat e varfra të shoqërisë. Qytetarët presin rezultate konkrete, me raste të hetuara dhe gjykuara që do të godasin këtë fenomen edhe në nivelet më të larta të shfaqjes së tij apo për afera me shuma të konsiderueshme. KShH, me mbështetjen e Ambasadës Britanike ka ngritur një rrjet të ri avokatësh për ndëshkueshmërinë e korrupsionit dhe mashtrimit financiar, kur nga këto vepra dëmtohet interesi publik.

Marrëveshja politike ndër-partiake e 18 majit për Zgjedhjet e Parlamentare në vendin tonë, edhe pse një mjet për zhbllokimin e ngërçit politik, nuk respektoi parimin kushtetues të ligjshmërisë dhe sigurisë juridike. Disa çështje të kësaj marrëveshje nuk u shoqëruan me ndryshimet e nevojshme në Kodin Zgjedhor. Monitorimi i zgjedhjeve nga KShH evidentoi se

pati shkelje të afateve të parashikuara në Kodin Zgjedhor në fuqi, ngritje me vonesë dhe trajnim jo-cilësor të komisionerëve të niveleve të dyta dhe të treta të administrimit zgjedhor, akuza reciproke të partive politike për shit-blerjen e votës, inaugurime qeveritare gjatë fushatës zgjedhore, cenim i heshtjes zgjedhore nga disa subjekte zgjedhore, disa incidente gjatë fushatës por dhe ditën e votimit, etj.

Angazhimet e Kuvendit për të realizuar reformën zgjedhore dështuan për shkak të polarizimit të skajshëm politik, i cili nuk mundësoi uljen e të gjitha palëve në një tryezë për të vendosur mbi interesat politikë, nevojën e zbatimit të rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it.

Gjatë 2017-ës, KShH ka reaguar publikisht në 46 raste dhe në total janë përcjellë dhe trajtuar 235 ankesa. Përafërsisht gjysma e këtyre rasteve vazhdon të dominohet nga ankesat e personave të privuar nga liria në sistemin e burgjeve. Ankesat për shërbim avokator përbëjnë 24 % të totalit, ndërsa konfliktet e pronësisë dhe nevoja për ndihmë ekonomike apo mbrojtje shoqërore, me rreth 11 % të totalit.

Në komunikimin që kemi pasur me institucionet e administratës publike, shpesh herë janë vërejtur reagime formale dhe shmangie nga kompetencat me natyrë mbikëqyrëse dhe të llogaridhënies karshi publikut, por dhe midis organeve eprorë dhe atyre të varësisë. Megjithatë janë vërejtur edhe raste pozitive, ku vlen të evidentohet fryma bashkëpunuese dhe reagimet pozitive për marrjen e masave në disa raste nga Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Edhe me Institucionet e Pavarura si Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, KShH ka pasur kryesisht përvoja pozitive të referimit dhe zgjidhjes së rasteve, me përjashtim të disa vonesave të vërejtura në vendimmarrjen e tyre për këto çështje.

Qytetarët vazhdojnë të përballen me mungesën e sigurisë për jetën dhe shëndetin e tyre, për shkak edhe të formave të ndryshme të kriminalitetit, ndërkohë që dhuna në familje mbetet shqetësuese, si rezultat i së cilës kanë humbur jetën disa vajza dhe gra në 2017-ën. Ndotja mjedisore në disa zona të vendit, si dhe mungesat në infrastrukturën shëndetësore dhe në medikamente në Spitalet publike, ka përbërë në disa raste rrezik serioz për jetën dhe shëndetin e shtetasve. Organet e qeverisjes vendore vijnë të përballen me pamjaftueshmëri të fondeve për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane, çka në disa raste kemi vërejtur se ka shkaktuar ndotje të konsiderueshme të hapësirave publike e sidomos shtretërve të lumenjve.

Gjatë vitit të kaluar, KShH ka vënë në lëvizje me nismën e saj ose ka përfaqësuar disa shtetas për çështje me interes publik para gjykatave vendase, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Strasburgut. Çështjet e përfaqësuara kanë pasur për objekt të drejtat e cenuara të njerëzve për ujë, ofrimin e shërbimit shëndetësor adekuat, për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm, për mosdiskriminim dhe barazi, të drejtën e votës, të drejtën për të mos ju nënshtruar torturës, trajtimit ç'njerëzor dhe degradues, të drejtën për zhdëmtim në rastet e fatkeqësive natyrore, e drejta për informim, konsultim publik, etj.

E shikojmë të nevojshme të theksojmë se 2 kërkesat tona drejtuar Gjykatës së Strasburgut gjatë 2017-ës kanë të bëjnë; e para, me cenimin e së drejtës së votës për një kategori të dënuarish dhe e dyta, për shkeljen e procesit të rregullt gjatë hetimeve paraprake nga prokuroria. Aktualisht, pranë kësaj gjykate janë në shqyrtim edhe 3 çështje të dërguara nga shtetas të përfaqësuar nga KShH, gjatë vitit 2016.

Të drejtat e personave të ndaluar dhe arrestuar në flagrancë nuk rezultojnë të jenë respektuar plotësisht nga organet e drejtësisë penale. Monitorimi i 400 seancave gjyqësore dhe studimi i 1800 vendimeve gjyqësore për masat e sigurimit personal në gjykatat e rretheve gjyqësore Tiranë dhe Durrës, evidentoi një përdorim tepër të lartë të masës së sigurimit “Arrest në burg”. Në këtë trend të gjykatës vlerësojmë se ka ndikuar edhe ashpërsimi i politikës penale. Arresti në burg zbatohet në përqindje të lartë edhe kur të ndaluarit akuzohen për vepra penale që nuk paraqesin rrezikshmëri të theksuar shoqërore, ndaj të ndaluarve të mitur, të rinjve të moshës 18-21 vjeç dhe ndaj grave.

KShH ka kryer rreth 22 misione verifikimi ankesash në sistemin e burgjeve. Mbipopullimi vazhdon të jetë shqetësues veçanërisht sektorët e paraburgimit, duke shkaktuar vendosjen e të paraburgosurve dhe të dënuarve në dhomat e veçimit, ku duhet të mbahen vetëm personat me masë disiplinore. Mosmiratimi nga Kuvendi i amnistisë për vitin 2017 si dhe shfuqizimi i nenit 478 të Kodit të Procedurës Penale (lirimi i të dënuarve për shkak të sëmundjes), përbëjnë regres në drejtim të standardeve që kërkohen nga politika penale bashkëkohore që duhet të përshkohet nga humanizmi dhe trajtimi human.

Në një pjesë të Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, sidomos në atë të Krujës (Zahari), Sarandës, Lezhës, Vaqarrit, Burrelit, etj, kushtet nuk përmbushin as kërkesat minimale, madje në to janë të pranishme elementë të trajtimit ç'njerëzor dhe degradues. Në raste sporadike, KShH ka konstatuar shenja dhune tek të dënuarit, të cilët pretendojnë se janë dhunuar nga stafi me uniformë i burgjeve. Gjithashtu ka pasur 5 raste të vetëvrasjes në sistemin e burgjeve, çka vë në pikëpyetje elementët e sigurisë dhe mbikëqyrjes.

Mungesa në personelin mjekësor dhe në medikamente, mungesa e vëmendjes së duhur ndaj programeve edukuese dhe rehabilituese, akomodimi në kundërshtim me ligjin i mbi 160 personave me probleme të shëndetit mendor me masë mjekësore, në sistemin e burgjeve, infrastruktura e papërshtatshme e disa institucioneve dhe numri i kufizuar i punonjësve social dhe psikologë, ankesat për praktikat korruptive në dhëniet e lejeve dhe uljet e dënimit përbëjnë bazën e problemeve të konstatuara në burgje dhe paraburgime gjatë 2017.

Për vitin 2017, monitorimet e ushtruara në Komisarariatet e Policisë kanë qenë më të pakta në numër dhe nuk janë konstatuar raste dhune. Kushtet infrastrukturore të ambienteve të ndalimit/arrestimit në komisariate kanë nevojë për investime të ndjeshme. Monitorimet e kryera në pikat e kalimit kufitar dhe institucione të tjera të trajtimit të azilkërkuesve dhe refugjatëve në Shqipëri, evidentojnë mungesa në infrastrukturë, personel dhe shërbime. Flukset emigratore janë ende të paqëndrueshme në rajon dhe para një situatë eventuale emergjence, vendi ynë mund të përballej me kapacitete tepër të kufizuara të pritjes. Studimi i realizuar nga KShH për vendimet e gjykatave vendase për emigrantët që kalojnë pikat e Kalim Kufirit në Shqipëri, evidenton se janë dënuar me burg në kundërshtim me standardet ndërkombëtare, duke i dhënë prioritet Kodit tonë Penal, të huajt që kanë hyrë në mënyrë të parregullt, përfshirë edhe shtetasit sirianë, të cilët janë larguar nga vendi i tyre për shkak të luftës.

Mosrespektimi i afateve ligjore të njoftimit për prishjen e 250 banesave në Shkozë si dhe mungesa e alternativave të qëndrueshme të strehimit për njerëzit në nevojë ka cenuar të drejtën e pronës dhe jetën e qetë familjare. Vendimet e Gjykatës së Strasburgut për dëmshpërblim për cenimin e së drejtës së pronësisë krijojnë detyrimin e shtetit shqiptar për të paguar shuma tepër të larta që rëndojnë te taksapaguesit shqiptarë. Nga ana tjetër, ish pronarët vijojnë të presin prej 27 vitesh për të gëzuar të drejtat e tyre legjitime të pronësisë. Kompensimi i pjesshëm i ish pronarëve me këste në periudhë afatgjatë ka krijuar tek ta

shqetësim të vazhdueshëm, ndjesi të padrejtësisë dhe mosrespektimit të parimit të sigurisë juridike.

KShH ka kontribuar edhe në përmirësimin e ligjeve dhe akteve nënligjore, përfshi këtu edhe paketën ligjore të reformës në drejtësi. Gjithashtu është monitoruar zbatimi i ligjeve ku vlen të përmendet ligji për njoftimin dhe konsultimin publik. Ky ligj rezulton të jetë zbatuar në nivele të ulëta apo me nota formalizmi nga institucionet në nivel qendror, nuk respektohen kërkesat për afatet dhe procedurat e konsultimit publik, duke cenuar parimin e transparencës dhe të qeverisjes së hapur. Nga ana tjetër është vërejtur mungesë e besimit të vetë grupeve të interesit në procesin e konsultimit publik dhe tek institucionet që e realizojnë atë.

KShH ka ndërmarrë një fushatë ndërgjegjësuere dhe parandaluese për ekstremizmin dhe radikalizmin në vendin tonë. Përdorimi i lartë i hapësirës digjitale nga grupe ekstremiste shqipfolëse për të rekrutuar kryesisht të rinjtë që përdorin rrjetet sociale, kërkon mbështetje të plotë në burime njerëzore dhe infrastrukturë të agjencive të specializuara ligj zbatuese, si dhe koordinim të masave për parandalimin dhe adresimin e këtij fenomeni.

Ndikimi i zhvillimit të epokës digjitale, të lidhjeve të papërshtatshme të interesave të biznesit dhe politikës me median, cenimi i të drejtave bazë të punëmarrësve gazetarë, mungesa e solidaritetit mes gazetarëve, përdorimi i *fake news*, si dhe etiketimet me ngjyrim ofenduese ndaj medias vijnë të dëmtojnë fjalën e lirë dhe integritetin moral dhe profesional të gazetarëve.

GJETJET KRYESORE

1.1 E drejta e jetës dhe shëndetit

E drejta e jetës, siç dihet është e drejtë themelore dhe parakusht për të gëzuar dhe ushtruar efektivisht çdo liri apo të drejtë njerëzore². Shteti ka jo vetëm detyrimin negativ për të mos e cenuar këtë të drejtë, por edhe detyrimin pozitiv për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve.

Sipas informacioneve në media dhe ankesave drejtuar KShH-së rezulton se qytetarët vazhdojnë të përballen me mungesën e sigurisë për jetën dhe shëndetin e tyre, për shkak edhe të formave të ndryshme të kriminalitetit. Qytetarët përballen me rrezikun si pasojë e veprimtarisë ende të fuqishme të krimit të organizuar, të ngritur si shqetësim edhe nga Departamenti Amerikan i Shtetit, në Raportin e Krimit dhe Sigurisë në Shqipëri 2017³.

KShH vlerëson faktin se statistikat e fundit tregojnë një rënie në disa kategori të rëndësishme krimit⁴ duke përfshirë vrasjet, vrasjet në tentativë, vjedhjet me dhunë apo me armë, megjithatë ekziston nevoja për marrjen e masave më efektive në uljen dhe parandalimin e “krimit të rrugës” si; vjedhje të pasurisë apo dhuna në familja, si rezultat i së cilës kanë humbur jetën disa vajza dhe gra në 2017-ën. Konkretisht Policia e Shtetit ka evidentuar rreth 250 raste më shumë të dhunës në familje krahasuar me vitin paraardhës, 16 viktima të kësaj dhune me pasojë vdekjen e tyre, si dhe rreth 60 kërkesa më shumë për urdhër mbrojtje, në raport me vitin pararendës. Viktimat e këtij krimi vazhdojnë të prekin masivisht gratë, fëmijët dhe të moshuarit, të cilët nuk gëzojnë ende një mbrojtje adekuate nga shteti.

Kujdesi shëndetësor vijon të mbetet një problem serioz në vend pasi kujdesi përtej ndihmës së parë është i kufizuar dhe nuk ka spitale të traumës jashtë Tiranës⁵. Mungesat në kujdesin shëndetësor në Burgje, Paraburgime, Komisariate apo Pika Kalimi Kufitar, nevoja për medikamente apo pajisje mjekësore në shërbimin e Hematologjisë të QSUT-së apo për mundësimin e dëgjimit të të miturve, ndotja mjedisore në disa zona të vendit dhe kushtet e papërshtatshme infrastrukturore në institucionet penitenciare përbëjnë rrezik serioz për jetën dhe shëndetin e shtetasve.

Gjatë vitit 2017, KShH ka vijuar të ndjekë pranë Institucioneve të specializuara apo në rrugë gjyqësore mungesën e pajisjeve mjekësore të posaçme për të miturit që kanë probleme me dëgjimin, që në lindjen e tyre, sigurimit të ujit të pijshëm për banorët e fshatit Visokë, Bashkia Mallakastër, mungesën e medikamenteve për të sëmurët në Pavijonin e Hematologjisë në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Pavarësisht adresimit mediatik të vazhdueshëm për nevojën e përmirësimit të infrastrukturës dhe sinjalistikës rrugore, mbetet shqetësues mungesa e sigurisë në rrugë dhe rastet e aksidenteve rrugore me pasoja të rënda për jetën dhe shëndetin e njerëzve.

² Neni 15 i Kushtetutës: “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. Organet e pushtetit publik, në përbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre”.

³ Albania 2017 Crime & Safety Report

⁴ <http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/krimet-dhe-drejt%C3%ABsia-penale/#tab2>

⁵ <file:///C:/Users/user/Downloads/Albania%202017%20raport%20OSAC.pdf>

1.2 E drejta për të zgjedhur e për t'u zgjedhur

Ashtu si më parë, KShH ka monitoruar edhe Zgjedhjet Parlamentare të dt. 25 Qershor 2017 dhe në Korrik 2017 publikoi Raportin përfundimtar të monitorimit⁶. Edhe pse monitorimi ynë ka qenë i pjesshëm, duke pasur parasysh edhe raportin përfundimtar të OSBE/ODIHR-it, arrihet në përfundimin se legjislacioni zgjedhor për disa çështje duhet të rishikohet. Në këtë drejtim,

Nga monitorimi disa mujor, KShH konstatoi shkeljen të afateve të parashikuara në Kodin Zgjedhor, ngritjen me vonesë dhe trajnimin jo-cilësor të komisionerëve të niveleve të dyta dhe të treta të administrimit zgjedhor apo mungesën e tyre në disa raste, akuzat reciproke të partive politike për shit-blerjen e votës, inaugurimet qeveritare gjatë fushatës zgjedhore, cenimin e heshtjes zgjedhore nga disa subjekte zgjedhore, disa incidente gjatë fushatës por dhe ditën e votimit, etj. Problematikate konstatuara dhe të tjera, evidentojnë nevojën për rregullimin ligjor të mbulimit të fushatës zgjedhore të subjekteve politike duke respektuar lirinë editoriale të medias, rëndësinë e depolitizimit të organeve të administrimit zgjedhor të të gjitha niveleve, respektimin e barabartë të të drejtave të vëzhguesve të shoqërisë civile me ata partiakë, nevojën për ndryshimin e Kodit Zgjedhor për të parandaluar ndërhyrjet apo pengesat e procesit të numërimit të votave për shkak të pranisë së kandidatëve në vendet e numërimit të votave, garantimin e integritetit moral dhe profesional të gazetarëve që monitorojnë dhe raportojnë për pasqyrimin e fushatës zgjedhore në media, etj.

Marrëveshja politike ndër-partiake e 18 majit, edhe pse shërbeu si një mjet për zhblokimin e ngërçit politik, nuk respektoi parimin kushtetues të ligjshmërisë dhe sigurisë juridike. Disa çështje të kësaj marrëveshje nuk u shoqëruan me ndryshimet e nevojshme në Kodin Zgjedhor, veçanërisht ndryshimi i kryetarit të KQZ-së.

Reforma zgjedhore që duhet ti paraprinte këtyre zgjedhjeve dështoi për shkak të polarizimit të skajshëm politik, i cili nuk mundësoi uljen e të gjitha palëve në një tryezë për të vendosur mbi interesat politik, nevojën e zbatimit të rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it. Edhe me ngritjen e Komisionit të ri të Reformës Zgjedhore pas zgjedhjeve të 28 Qershorit, sërish vërehet se ka vonesa dhe mungon vullneti politik për të ndryshuar Kodin Zgjedhor, ku duhet të mbizotërojnë interesi publik dhe orientimi drejt standardeve ndërkombëtare dhe rekomandimeve të OSBE/ODIHR, për të cilat KShH ka adresuar sugjerimet shkresërisht.

Duke vlerësuar se, kriteret kufizuese të së drejtës së votës për të dënuarit me burg sipas Ligjit 138/2015 për dekriminalizimin nuk janë proporcionale dhe as të argumentuara dhe si të tilla bien ndesh me Kushtetutën dhe Protokollin 1, të KEDNJ-së, në muajin Shkurt 2017, KShH i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e disa neneve të këtij Ligji. Meqë argumentet e paraqitura në Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 43 (2017) i konsideruam të pabazuara, i jemi drejtuar Gjykatës së Strasburgut, pasi siguruam Autorizimet nga disa shtetas që po ekzekutojnë dënimet me burg në IEVP Peqin dhe në IEVP Vaqarr.

1.3 E drejta e pronës

Kushtetuta, në nenin 41 të saj parashikon kufizimin e të drejtës së pronës vetëm për interesa publike, ndërkohë që shteti duhet të garantojë në çdo rast thelbin e kësaj të drejte për shkak të rëndësisë që ka ajo në një shoqëri demokratike, me një ekonomi tregu funksionale.

Problemi historik i pazgjidhur i respektimit të së drejtës së pronës në vend vijon të pengojë zhvillimin ekonomik dhe konsolidimin e zbatimit të ligjit.

⁶<http://www.ahc.org.al/wp-content/uploads/2017/07/Raporti-per-Zgjedhjet-per-Kuvendin-25-Qershor-2017.pdf>

Ankesat e ardhura në adresë të KShH-së gjatë vitit 2017, evidentojnë se 7.2 % e qytetarëve ankohen për cenim të së drejtës së pronësisë, duke shënuar një ulje të të lehtë të rasteve në raport me vitin e mëparshëm. Mosrespektimi i afateve ligjore të njoftimit për prishjen e 250 banesave në Shkozë, koha e papërshtatshme e prishjes së tyre dhe mungesa e alternativave të qëndrueshme të strehimit për shtresat vulnerabël, veçanërisht të varfra apo të minoriteteve rome-egjiptiane, janë shkelje prezentë gjatë 2017 të së drejtës së pronës dhe i vendos grupe të caktuara shoqërore në pozita diskriminuese dhe të pambrojtura, në kundërshtim me frymën dhe standardet ndërkombëtare të detyrueshme për zbatim. Gjithashtu, pranë KShH-së janë adresuar ankesa nga banorë të bashkive të tjera të vendit, me pretendimin e mungesës së njoftimeve apo shkeljen e procedurave administrative për prishjen e ndërtesave që shërbejnë si banim për shtetasit, pa iu siguruar paraprakisht mundësitë reale të strehimit.

Vlen të evidentohet si zhvillim pozitiv, konkretizimi i nismës së qeverisë për hartimin e një projektligji të ri për strehimin social, i cili synon të krijojë një kuadër ligjor të ri për ofrimin e strehimit social dhe të procesit administrimit dhe planifikimit të programeve sociale në këtë fushë, në përputhje me aktet dhe standardet ndërkombëtare.

Pretendimet për kompensim të padrejtë të shpronësimeve për shkak të zbatimit të projektit TAP janë evidentuar gjatë monitorimeve të përbashkëta të KShH-së me organizatën Bankwatch. Vendimet e Gjykatës së Strasburgut për dëmshpërblim për cenimin e së drejtës së pronësisë krijojnë detyrimin e shtetit shqiptar për të paguar shuma tepër të larta që rëndojnë tek taksapaguesit shqiptarë. Nga ana tjetër, ish pronarët vijnë të presin prej 27 vitesh për të gëzuar të drejtat e tyre legjitime të pronësisë. Kompensimi i pjesshëm i ish pronarëve me këste në periudhë afatgjatë ka krijuar tek ta shqetësim të vazhdueshëm, ndjesi të padrejtësisë dhe cenim të parimit të sigurisë juridike.

1.4 Liria e Medias

Në vitin 2017, KShH ka vijuar të vlerësojë informacionin e dhënë në media, duke rritur numrin e rasteve të verifikuara dhe reagimet publike për shkeljet e të drejtave dhe lirive të shtetasve. KShH ka monitoruar në terren disa raste, që lidhen me mirëqeverisjen me pasoja në cenimin e së drejtës së jetës, shëndetit, për një mjedis ekologjikisht të pastër dhe për strehim, në disa zona të vendit, falë nxitjes nga emisione investigative që transmetohen në media.

Liria e shtypit dhe gazetarëve në vend ka probleme të dukshme dhe serioze, përfundim ky, edhe i raportit të përvitshëm për Lirinë e Shtypit nga Organizata Reporterët pa Kufij⁷, ndërsa Freedom House e rendit Shqipërinë në 3 vendet e fundit në Evropë, për vitin 2017. Informacioni i institucioneve shtetërore vlerësohet i cunguar dhe i vështirë për tu siguruar si nga gazetarët, ashtu dhe nga qytetarët. Kjo situatë ndikon drejtpërsëdrejti në cenimin e misionit të medias për të marrë dhe për ti dhënë informacion publikut.

KShH ka reaguar publikisht⁸ duke evidentuar ndikimin politik, mungesën e një klime të plotë sigurie për gazetarët, mungesën e profesionalizmit dhe paanshmërisë për shkak të cenimit të statusit ekonomiko-social të përcaktuar në ligj, nevojën e respektimit të etikës gazetareske që shmanë gjuhën e urrejtjes dhe fjalorin e papërshtatshëm, si dhe shqetësimin për cenimin e

⁷<https://rsf.org/en/albania>

⁸ Deklaratë e përbashkët me Këshillin e Medias me rastin e ditës botërore të lirisë së medias, dt. 03.05.2017

proporcionalitetit ndërmjet pavarësisë së gazetarëve dhe respektimit të parimit kushtetues të prezumimit të pafajësisë.

Konferenca e realizuar nga KShH, për lirinë e shtypit dhe të gazetarëve gjatë vitit 2017, evidentoi lidhjet e papërshtatshme të interesave të biznesit dhe politikës me median. Shqetësues është fakti se vetë media vazhdon të pranojë se ka gazetarë që nuk paguhen dhe janë pa sigurime shoqërore, se ka mungesë të solidaritetit mes tyre, se në disa raste *fake news* përdoret si kundërpeshë për t'ju kundërvënë medias. Etiketimet me ngjyrime ofenduese ndaj medias dhe gazetarëve vijnë të dëmtojnë fjalën e lirë dhe integritetin moral dhe profesional të gazetarëve. Nga ana tjetër adresohet si nevojë respektimi i etikës gazetareske dhe nevoja për vëmendje të shtuar të medias ndaj grupeve në nevojë. Referuar hulumtimeve të prezantuara në këtë konferencë, në disa raste media bëhet burim diskriminimi nëpërmjet imazheve të ngarkuara me “vlera” që reflektojnë stereotipa mbi grupe të ndryshme sociale, veçanërisht ndaj komuniteteve Rome, Egjiptiane, Personave me orientim të ndryshëm seksual (LGBTI), Personave me Aftësi të Kufizuar apo stereotipave me bazë gjinore.

1.5 Drejtësia

1.5.1 Reforma në Sistemin e Drejtësisë

Në pritje të rezultateve të para të zbatimit të reformës në drejtësi, tepër e rëndësishme për rikthimin e besimit të shtetasve në organet e drejtësisë, gjatë vitit 2017 janë vërejtur vonesa në ngritjen në kohë të organeve të reja të drejtësisë. Në disa raste, këto vonesa kanë qenë të pajustificuara dhe kanë ardhur si rezultat i polarizimit politik apo mungesës së dialogut dhe konsensusit politik, për vendimmarrje të lidhura me veprimtarinë e Kuvendit dhe organeve parlamentare.

Për ngritjen e institucioneve të vettingut, vëzhguesit e KShH-së kanë vërejtur gjatë monitorimit, se edhe pse komisioni i parë parlamentar ad hoc verifikues konstatoi se disa kandidatë plotësonin kriteret formalo – ligjore, ndaj tyre u drejtuan pyetje paragjyquese dhe të njëanshme, duke i vënë kandidatët nën presionin politik-psikologjik. Seanca dëgjimore me këta kandidatë duhet të kishte si objekt kryesor testimin e nivelit profesional dhe integritetit të tyre. Veç kësaj, në dy komisionet e tjera parlamentare ad hoc të përzgjedhjes së kandidatëve, u vërejtën elementë të formalizmit, për shkak të mungesës së një pjese të anëtarëve të këtyre komisioneve apo të indiferencës së treguar prej tyre gjatë seancës dëgjimore. Gjithashtu, u vërejt se pati një numër të lartë kandidatësh të cilët nuk u përzgjedhën, por ndërkohë ishin arsimuar ose kishin pasur përvoja të vlerësueshme në vendet përëndimore. Pengesë në këtë drejtim ishin edhe kriteret e forta kushtetuese dhe ligjore.

Megjithatë, KShH ka konstatuar se gjatë 2017-ës, ecuria e zbatimit të Reformës në Drejtësi është ngadalësuar edhe për shkak të lidhura me ushtrimin e mekanizmave të ankimit, si p.sh. ushtrimi i së drejtës së shoqatave të gjyqtarëve dhe prokurorëve për të kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese disa prej ligjeve organike të sistemit të drejtësisë, *veçanërisht ligjit të vettingut nr.84/2016*. Kjo ndikoi në krijimin e vonesave në ngritjen e organeve të vettingut, zbatimin e tij si dhe ngritjen e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë (KLGJ dhe KLP). Në vonesat për ngritjen e KLGJ dhe KLP ndikuan gjithashtu kriteret e forta kushtetuese dhe ligjore për anëtarët jo gjyqtarë dhe jo prokurorë, sidomos për pozicionin e anëtarit nga shoqëria civile.

Vonesat në ngritjen e Këshillave të Lartë Gjyqësor dhe të Prokurorisë (KLP dhe KLGJ) si dhe e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi kanë ndikuar në mënyrë zinxhir në mosplotësimin e vakancave në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën Kushtetuese, në emërimin e Prokurorit të

Përgjithshëm me mandat të plotë, si dhe në mos ngritjen në kohë të strukturave të specializuara anti-korrupsion, të shumëpritura për të luftuar korrupsionin dhe pandëshkueshmërinë e tij. Të gjitha këto vonesa, kanë krijuar pengesa të herëpashershme në veprimtarinë e institucioneve ekzistuese duke dëmtuar efikasitetin e gjykimit dhe drejtësinë e kërkuar nga qytetarët, në mënyrë të veçantë në Gjykatën Kushtetuese dhe në Gjykatën e Lartë. Vlen të përmendim se kjo e fundit aktualisht vijon të përballet me një mbingarkesë tepër të lartë për shkak edhe të dosjeve të mbartura nga vitet e kaluara.

Zgjedhja e Prokurorit të Përgjithshëm të Përkohshëm, siç parashikohet në ligj u polarizua në mënyrë të tejskajshme, çka ndikoi negativisht në arritjen e konsensusit dhe u shoqërua me veprime të dhunshme jashtë Kuvendit por edhe në ambientet e seancës plenare, në shkelje të hapur të etikës parlamentare dhe qytetarisë. KShH reagoi publikisht duke theksuar se, kundërshtimi i vendimeve që konsiderohen antikushtetues në çdo rast duhet të realizohet me mjete ligjore dhe paqësore, duke respektuar parimin e ligjshmërisë, stabilitetin e institucioneve dhe shtetin e të drejtës.

Për monitorimin e vettingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve, KShH ka bashkëpunuar me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, ku ndër të tjerash është vërejtur mungesë transparence karshi publikut për të dhëna të cilat nuk janë sensitive dhe që mund të kontribuonin për një aktivizim dhe besim më të lartë të publikut në fazat e para të zbatimit të vettingut. Për shkak të mosdhënies së informacionit të nevojshëm statistikor nga organet ndihmëse të vettingut, KShH paraqiti katër (4) ankime administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit ndaj Prokurorisë së Përgjithshme, DSIK-së, KLD-së dhe ILDKPKI-së. Vendimarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit edhe pse për tre nga këto institucione u shoqërua me vonesë, në përfundim rezultoi me konstatimin e shkeljes të së drejtës së informimit nga DSIK dhe ILDKPKI.

KShH ka monitoruar pjesërisht procesin e përzgjedhjes së anëtarëve jo prokurorë dhe jo gjyqtarë në KLGJ dhe KLP, i cili është zhvilluar në një klimë tepër të polarizuar politike, para dhe gjatë procedurave të zhvilluara në nën komisionin parlamentar. Përzgjedhja me short e kandidatëve, në mungesë të konsensusit mes anëtarëve të nën komisionit parlamentar, edhe pse një mënyrë për ta zhbllokuar procesin vlerësojmë se nuk garantoj plotësisht zgjedhjen e anëtarëve të KLGJ dhe KLP, mbi bazë merite dhe integriteti.

Për shkak të rëndësisë së pjesëmarrjes qytetare dhe shoqërisë civile në zbatimin e kësaj reforme, me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Shqipëri, KShH ka zbatuar nismën për promovimin e pjesëmarrjes qytetare duke vijuar nga viti 2016 dhe fillimi i 2017-ës, me informimin e studentëve, përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile, avokatëve dhe profesionistëve të ligjit për risitë e amendamenteve kushtetuese dhe gjashtë ligjeve të para organike të sistemit të drejtësisë. Ndryshimet janë radikale dhe paketa e reformës në drejtësi është voluminoze, ndaj qytetarët kanë ende nevojë për më tepër ndërgjegjësim lidhur me risitë e reformës dhe në mënyrë të veçantë për ndryshimet mbi organizimin dhe funksionimin e gjyqësorit dhe aksesin e tyre në gjykata.

1.5.2 Ankesat ndaj Gjyqësorit dhe Prokurorisë

Gjatë 2017, rreth 7.66 % e ankesave të ardhura në zyrën tonë të Klinikës Ligjore Falas, i atribuohet sistemit gjyqësor, përkatësisht, vendimeve të padrejta gjyqësore, tejkallimit të afateve të paraburgimit, shkeljes së procesit të rregullt gjyqësor, veprimeve të padrejta dhe arbitrare të organit të akuzës, mungesës së dhënies së informacionit nga gjykatat, dhe në numër më të vogël ankesat për veprime të padrejta, arbitrare dhe shkelje procedurale hetimore nga

prokuroria. Ankesat drejtuar KShH-së për shërbim avokator janë në masën e 24.25 % të totalit dhe tregojnë nevojën e shtetasve për mbrojtje ligjore efektive dhe nga ana tjetër besueshmërisë ndaj organizatave jo-qeveritare në ofrimin e shërbimeve ligjore.

Të drejtat dhe garancitë procedurale që lidhen me lirinë dhe sigurinë,garantuar nga neni 5 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në mjaft raste nuk janë respektuar si nga policia ashtu edhe nga prokuroria dhe gjykata. Është fjala për ndalimin, arrestimin në flagrancë dhe vleftësimin e masave të sigurimit personal. Nga monitorimi i 400 seancave gjyqësore dhe studimi i 1817 dosjeve të vendimeve gjyqësore për vleftësimin e ndalimit/arrestimit dhe masave të sigurimit personal në gjykatat e rretheve gjyqësore të Tiranës dhe Durrësit, KShH ka konstatuar aplikim të lartë dhe shqetësues të masës së sigurimit “arrest në burg”. Në këtë drejtim, ka ndikuar edhe ashpërsimi i politikës penale nga Kuvendi. Në 64% të rasteve organi i akuzës kërkon zbatimin e kësaj mase të sigurimit personal, për një numër të lartë veprash penale me rrezikshmëri jo të theksuar shoqërore si: “Drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt”, “Vjedhja”, “Vjedhja e energjisë elektrike dhe impulseve telefonike”etj, ndërkohë që gjykata ka vleftësuar masën e arrestit në 79% të kërkesave të prokurorisë Alternativat e “arrestit në burg” zbatohen shumë pak (përsëmbull arresti në shtëpi dhe garancia pasurore përbëjnë së bashku 9 % atë masave të sigurimit personal të dhënë nga gjykata.



Mungesa e konsekuencës në praktikën e ndjekur gjyqësore, numri i lartë i masave të sigurimit personal arrest në burg për vepra penale relativisht të lehta, roli pasiv i gjykatës në konstatimin e shkeljeve procedurale dhe lirive procedurale të të ndaluarit/arrestuarit dhe mungesa e arsytimit formalo-juridik mbi rrethanat e faktit nga ana e gjykatës në disa raste, janë problemet më të rëndësishme të rezultuara nga studimi i KShH-së.

Sikurse në vitet e kaluara, KShH ka konstatuar aplikimin e institutit procedural të “Gjykimit të shkurtuar” edhe në rastet kur vepra penale ka sjellë pasoja shumë të rënda, për shtetin apo shtetasit. Qëndrimi i shprehur vazhdimisht nga KShH për nevojën e ndryshimit të Kodit të Procedurës Penale dhe një praktike të unifikuar për gjykatat, me qëllim pengimin e favorizimit duke ulur me 1/3 masën e dënimit të dhënë për personat që janë recidivistë apo me rrezikshmëri të lartë shoqërore, nuk kanë gjetur adresim në ndryshimet e fundit të Kodit të Procedurës Penale.

Nisur nga gjetjet e monitorimit të përdorimit të sallave gjyqësore dhe sistemit të regjistrimit audio të seancave gjyqësore në të gjitha gjykatat e vendit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Kuvendi dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor që pritet të krijohet, duhet të

hartojnë politika dhe strategji apo të krijojnë mbështetje financiare për kapërcimin e vështirësive sidomos atyre infrastrukture që hasin gjykatat me qëllimin final përdorimin 100 % të sallave të gjyqit dhe të sistemit të regjistrimit audio. Përsa i përket përdorimit të Sistemit të regjistrimit audio, monitorimi i kryer nga vëzhguesit e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, gjatë periudhës Janar-Mars 2017 (përmendur më lart) evidentoi se gjithsej, volumi i seancave të regjistruara me këtë sistem, në të gjitha gjykatat e vendit arriti në 91.5%. Megjithatë, kjo përqindje ndryshon nga gjykata në gjykatë, të cilat kategorizohen në gjykata që e përdorin 100% sistemin audio, gjykata që e përdorin në një shkallë të lartë por jo 100% dhe gjykata që e përdorin në një nivel më të ulët.


1.5.3 Shërbimi ligjor falas

Mungesa e efektivitetit dhe profesionalizmit të avokatëve të caktuar kryesisht nga organet e procedimit penal, si dhe kapacitetet e pamjaftueshme financiare dhe burimeve njerëzore të Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike, kanë vijuar të jenë arsyet që qytetarët i janë drejtuar organizatave të shoqërisë civile për ndihmë ligjore falas.

KSHH ka vijuar edhe gjatë 2017-ës të kontribuojë në drejtim të ofrimit të shërbimeve ligjore pa pagesë me anë të zyrës së Klinikës Ligjore Falas për shtresat në nevojë, në kuadër të mbështetjes së dhënë nga donatorë të ndryshëm. Personat me liri të kufizuar, anëtarë të Komunitetit Rom dhe Egjiptian, gratë, persona me aftësi të kufizuar, personat që nuk kanë mundësi financiare për të paguar një avokat, fëmijët e mitur të sëmurë, shtetas në zona rurale me mungesë në aksesin e shërbimeve publike, etj., përbëjnë disa nga grupet shoqërore që kanë përfituar nga këshillimi, asistenca në plotësim dokumentacioni, verifikimi në vend dhe ndërhyrja institucionale, si dhe përfaqësimi në gjykatë.


Gjatë vitit 2017 janë trajtuar rreth 235 ankesa. Përkatësisht, 48 % e këtyre rasteve vazhdon të dominohet nga ankesat e personave të privuar nga liria në institucionet penitenciare, për shkeljen e të drejtave të tyre nga administrata e burgjeve, kushtet e papërshtatshme të akomodimit, mosdhënien e shërbimit shëndetësor apo kujdesi social në burgje, pretendime për ushtrim dhune, apo transferim/mos transferim të parregullt në një institucion tjetër apo brenda të njëjtë institucion. 7.66 % e ankesave i atribuohet sistemit gjyqësor, ndërkohë që ankesat për shërbim avokator kanë qenë në masën e 24.25 % sikurse është evidentuar edhe më herët në këtë raport. Ankesat për konfliktet e pronësisë dhe nevoja për ndihmë ekonomike apo mbrojtje shoqërore, kanë shënuar rreth 10.6 % të ankesave.

Nga 235 ankesa gjate vitit 2017



KSHH ka reaguar publikisht në 46 raste, 16 prej të cilave duke marrë shkas nga informacionet e medias. Reagimet tona kanë qenë për shkelje të të drejtave në sistemin e burgjeve, për shkeljen e etikës parlamentare dhe nevojën e forcimit të parlamentarizmit, për mungesën e transparencës dhe konsultimit publik në proceset vendimmarrëse, për ndotjen e vazhdueshme apo sporadike të mjedisit në disa zona të vendit (*Mallakastër, Librazhd, Krujë, Tërkuzë, etj.*), për nevojën e Reformës Gjyqësore dhe shkeljet e Kodit Gjyqësor gjatë procesit parajudhësor, të votimit dhe numërimit të Gjydhjeve të Përgjithshme Parlamentare të 2017-ës, për vëmendje më të madhe në luftën ndaj përdorimit të lëndëve narkotike nga të miturit dhe mbrojtjen efektive të tyre nga dhuna në sistemin arsimor para universitar, për ngujimin e disa të miturve për shkak të pafuqisë së shtetit ndaj fenomenit të gjakmarrjes, për dhunën në familje me pasoja tragjike, etj.

Ankuesit i përkasin grup moshave të ndryshme, pothuajse të gjithë të rritur, qyteteve të shpërndara gjeografikisht, veçanërisht të lidhura me vendndodhjen e institucioneve penitenciare, por me një përqendrim prej rreth 25 % të tyre në Tiranë. Individët që i janë adresuar KSHH-së për trajtimin e shqetësimeve të tyre i përkasin të dyja gjinive, ku më së shumti dominojnë meshkujt e rritur në rreth 92 %. Rreth 6.4 % e ankesave vijnë nga shtetasit që i përkasin minoriteteve, kryesisht persona të minoritetit rom.



Gjatë 2017 rastet e litigimit strategjik janë shtuar konsiderueshëm, ku me anë të përfaqësimit ligjor të të drejtave të një ose disa shtetasve për një rast specifik, synohet zgjidhje për një grup më të gjerë personash që ndodhen në të njëjtën situatë ose në situatë të ngjashme.


Për përfaqësimin e këtyre rasteve, KShH i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatës së Apelit Administrativ, Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, Gjykatës Administrative Durrës, Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë, Gjykatës së Apelit Tiranë, etj. Pranë këtyre gjykatave janë ndjekur rreth 15 raste, duke mbrojtur kauza të lidhura me të drejtën e jetës, shëndetit, mjedisit ekologjik (Krujë, Kamëz, Mallakastër, etj.), të drejtën për të votuar, të drejtën për proces të rregullt, të drejtën për jetë të qetë familjare dhe private nëpërmjet detyrimit për furnizimin me ujë të pijshëm (p.sh. në fshatin Visokë, Mallakastër), përfitimin e pensionit të pleqërisë, të drejtën për të mos u diskriminuar për shkak të racës, gjendjes social-ekonomike, gjendjes shoqërore apo shëndetësore, etj. Objekti i kërkimeve në këto procese është lidhur me veprimet apo mosveprimet e organeve të administratës publike, qendrore dhe vendore, përgjegjëse direkt apo tërthorazi për këto shkelje.

Për disa nga çështjet e ndjekura prej tij, KShH ka ushtruar të drejtën e ankimit në gjykatë ndaj vendimeve Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kur kemi vlerësuar se vendimet e tyre për të drejtën e informimit dhe çështjet e diskriminimit nuk kanë qenë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Vlen të theksojmë se, për shumicën e çështjeve të adresuara pranë këtyre dy Institucioneve të Pavarura, ka pasur vendimmarrje në favor të zgjidhjes së ankesës së KShH-së për informacion dhe mbrojtje nga diskriminimi.

Gjatë vitit 2017, KShH i është drejtuar Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNJ) me 2 ankime për cenimin e së drejtës së votës së të dënuarve për shkak të ndalimeve në ligjin e “dekriminalizimit” dhe për konstatimin e procesit të parregullt ligjor ndaj një shtetasi gjatë hetimeve paraprake. Aktualisht, pranë kësaj gjykate vijnë të jenë në shqyrtim edhe 3 kërkesa të shtetasve të mbrojtur nga KShH, të depozituara gjatë 2016-ës.

1.6 Të drejtat e personave me liri të kufizuar

Sikurse është evidentuar më herët në këtë raport, 48% e ankesave drejtuar KShH-së kanë qenë pretendime për shkelje të të drejtave të burgosurve dhe paraburgosurve në sistemin penitenciar. Nga këto ankesa, 30.2 % dhe 14.5 % të tyre i referohen përkatësisht shkeljeve që lidhen me nenet 3 (ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor) dhe 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të KEDNJ-së, veçanërisht nga personat e privuar nga liria.



Në kuadër të trajtimit të ankesave, KShH ka kryer 22 misione verifikimi në Burgje, Paraburgime e Komisariate të Policisë. Konkretisht, misionet e monitorimit janë përqendruar në IEVP Peqin, IEVP Vaqarr, IEVP Fushë-Krujë, IEVP “Jordan Misja”, IEVP Fier, IEVP Burrel, IEVP Krujë, IEVP Durrës, IEVP Sarandë, si dhe IEVP Lezhë.

Mbipopullimi ka vijuar të jetë shqetësues, veçanërisht në sistemin e paraburgimit. Amnistia në fund të vitit mund të ndihmonte për lehtësimin e këtij fenomeni, por Kuvendi nuk ka miratuar një ligj amnistie në 2017-ën, çka vjen në kundërshtim me standardet e një politike penale humane dhe bashkëkohore, për të cilën KShH është shprehur publikisht⁹. Ky fenomen ka pasur kryesisht si shkaqe, zbatimin e lartë të masës së sigurimit “arrest në burg”, zbatimin e lartë të dënimit me burgim në vend të alternativave të tij dhe zbatimin në nivele jo të duhura të ligjit “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”.

Infrastruktura e dobët, mungesa e pajisjeve të nevojshme për jetesë dhe kushtet fizike në kundërshtim me sa parashikohet në legjislacionin ndërkombëtar dhe të brendshëm, veçanërisht në IEVP Krujë (Zahari), IEVP Sarandë, IEVP Lezhë, IEVP Vaqarr, IEVP Burrel, etj., akomodimi i të dënuarve/paraburgosurve pa masë disiplinore në ambientet e veçimit apo observimit për tej afatit ligjor (p.sh. Në IEVP Fier, IEVP Fushë-Krujë, IEVP “Jordan Misja”, etj.), pretendimet për ushtrim dhune nga stafi i sigurisë (të konstatuara në IEVP Peqin, IEVP Fier, IEVP Durrës), mungesa të theksuara në personelin e lartë mjekësor dhe në medikamente, si dhe mungesa e programeve edukuese e rehabilituese efektive ose pamundësia për t'i realizuar për shkak të mungesave në kushte infrastrukturore dhe të stafit të specializuar social, janë disa nga problemet e konstatuara nga KShH në sistemin tonë penitenciar dhe që vazhdojnë të ngrihen si shqetësime nga Komiteti për Parandalimin e Torturës (KPT) dhe Amnesty International.

Trajtimi çnjerëzor dhe degradues i të dënuarve në IEVP Krujë do të shmangej në rast se burgu i ri i Shkodrës, do të ishte vënë në funksion. Duke u nisur nga kushtet e trajtimit çnjerëzor dhe degradues të të dënuarit me burgim F.Z. të cilit prej vitesh nuk i ofrohet ndërhyrje kirurgjikale e specializuar sipas rekomandimit të mjekëve ortopedë, KShH ka paraqitur Kërkesën me objekt, lirim për shkak të sëmundjes, para se të shfuqizohej dispozita e Kodit të Procedurës Penale

⁹<http://www.ahc.org.al/aministia-tregues-i-nje-politike-penale-humane/>

(n.478) që parashikonte këtë mundësi për dënuarit që vuajnë nga sëmundje të rënda. KShH vijon paralelisht ta përfaqësojë këtë çështje në Gjykatën e Strasburgut.¹⁰

Gjatë vitit 2017, personat e akomoduar në sistemin e burgjeve kanë pretenduar në 5 raste ushtrim dhune, ku në 3 raste kjo dhunë i atribuohet punonjësve të sigurisë në sistem. Rasti më flagrant ishte ai i verifikuar në dt. 04.10.2017 në Sektorin e Sigurisë së Lartë të IEVP Peqin, ku Grupi i gatshëm i Policisë së Burgjeve, sipas të dhënave të monitorimit dyshohet se ka dhunuar të dënuarin V. G., me shkopinj gome në pjesë të ndryshme të trupit si në shpinë, bark dhe shputat e këmbëve. Eksperti mjeko-ligjor në përbërje të grupit të KShH, konstatoi në trupin e të dënuarit katër ekimoza në shpinë dhe një në këmbën e djathtë sipër gjurit me gjatësi nga 5-15 cm, si dhe një hematomë në bark, majtas, me gjatësi rreth 10 cm, me ngjyrë mavi dhe të kuqërremtë të theksuar. Dëmtimet ishin lehtësisht të dukshme dhe të freskëta. Këto veprime, në vlerësimin tonë përbëjnë elementë të veprës penale të parashikuar nga neni 86 i Kodit Penal “Tortura. Duke vlerësuar reagimin nëpërmjet masave administrative të Ministrisë së Drejtësisë në rastin konkret¹¹, shprehim shqetësimin për efikasitetin e hetimeve të prokurorisë lidhur me këto raste.

Gjatë 2017-ës ka pasur 5 raste të vetëvrasjeve në burgje si në IEVP Lezhë, Krujë, Rogozhinë dhe pranë rrugës “Mine Peza”. Këto raste evidentojnë nevojën për rritjen e masave mbikëqyrëse dhe të sigurisë sistemin e burgjeve, veçanërisht në kushte të vjetruara të ndërtesave apo aty ku mbahen të burgosur me probleme të shëndetit mendor. Hetimi i thelluar dhe gjithëpërfshirës administrativ dhe penal në rastet e vetëvrasjeve është një standard i zhvilluar nga GjEDNJ. Nga komunikimi që kemi pasur me prokurorinë edhe për rastet e vetëvrasjes që i përkasin viteve të kaluara, nuk rezultoi të jetë ngritur akuzë penale në gjykatë për vetëvrasjet në sistemin penitenciar, por është vendosur mosfillim i procedimit penal apo pushim i çështjes.

Akomodimi në sistemin e burgjeve i mbi 160 personave me probleme të shëndetit mendor, me masë mjekësore mjekim i detyruar në një institucion mjekësor është në shkelje flagrante të të drejtave të njeriut dhe legjislacionit në fuqi. Ky problem shqetësues që vazhdon për më shumë se dy dekada duhet të marrë zgjidhje të menjëhershme nga shteti ku përgjegjësia kryesore bie mbi organin e prokurorisë që ekzekuton në mënyrë të gabuar këto masa, mbi sistemin e burgjeve që pranon në kundërshtim me ligjin këta persona në institucionet në varësi të tij si dhe mbi Ministrinë e Shëndetësisë që nuk ka marrë masa për ndërtimin e një institucioni të specializuar mjekësor për këta shtetas.

Të dënuarit/paraburgosurit adresuan ankesa që tregojnë perceptim të lartë për korrupsion në administratën e burgjeve (pretendime të tilla kanë ardhur kryesisht nga IEVP Peqin, Fier, Burrel, Fushë-Krujë, Rogozhinë etj.), kryesisht në dhënie të lejeve shpërblyese, praktikat për uljen e dënimit, akomodimin nëpër dhoma etj.

Ndryshimi i shpeshtë i stafit të burgjeve brenda një periudhe të shkurtër, kryesisht atij drejtuesja ndikuar në vijimësinë normale të punës, duke shkaktuar vonesa ose moskthim përgjigje lidhur me shqyrtimin e kërkesave për leje shpërblyese pranë DPB ose kërkesave/ankesave të tjera. Është fakt i njohur që në burgjet tona, herë pas here, punonjës të veçantë janë shkarkuar nga detyra apo proceduar për korrupsion apo shpërdorim detyre.

Rehabilitimi i të dënuarve është larg standardeve të kërkuara për sa kohë numri i psikologëve dhe punonjësve socialë është tepër i ulët në raport me personelin e sigurisë. Gjithashtu, personeli i burgut duhet të fuqizohet nga pikëpamja e kapaciteteve dhe qëndrueshmërisë për të garantuar efektivisht rehabilitimin e të dënuarve. Rekrutimi në sistemin e burgjeve nuk

¹⁰ Në GjEDNJ pritet të jepet vendimi lidhur me Ankimin e të dënuarit F. Z., për shkeljen e neneve 3, 6/1, 13 dhe 14, të KEDNJ

¹¹ <http://www.ahc.org.al/multimedia/deklarata/>

mundëson punësimin e personave me integritet, të kualifikuar dhe të motivuar financiarisht. Zbatimin e programeve që synojnë rehabilitimin e të dënuarve, mund ta konceptojnë vetëm ata punonjës që me ndërgjegje dhe profesionalizëm angazhohen për të zvogëluar vuajtjen e dënimit, normalizimin e jetës në kushtet e burgut, inkurajimin e shpresës për jetën pas burgut.

KShH-ja ka përcjellë pranë institucioneve përkatëse, një numër të madh rekomandimesh dhe ka sugjeruar marrjen e masave për zbatimin e legjislacionit në fuqi, të cilat, përgjithësisht janë konsideruar në mënyrë konstruktive. Në mënyrë të veçantë, veçojmë bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Ministrinë e Drejtësisë, transparencën e treguar dhe reagimet me veprime administrative konkrete të këtyre institucioneve ndaj problematikave të adresuara për trajtim nga KShH. Veçanërisht, lidhur me mbajtjen e personave të burgosur në ambientet e veçimit dhe/ose observimit përkatësisht, pa masë disiplinore dhe përtej afatit të parashikuar në ligj, KShH e ka adresuar këtë problematikë nëpërmjet një letre të hapur pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për zgjidhje, më dt. 09.06.2017. Kjo ministri e ka deleguar zgjidhjen e çështjes tek Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, duke udhëzuar zgjidhjen e situatës nëpërmjet marrjes së masave të mundshme.

1.6.1 Respektimi i lirive dhe të drejtave të shtetasve nga strukturat e policisë dhe në pikat e kalim kufirit

Gjatë 2017 nuk ka pasur raste dhune të evidentuara nga KShH gjatë monitorimit në komisaritet e policisë, pavarësisht ankesave të trajtuara nga disa të dënuar për ngjarje të ndodhura vite të kaluara. Kushtet infrastrukturore të ambienteve të ndalimit/arrestimit në komisariate kanë nevojë për investime të ndjeshme.

Ankesat ndaj veprimeve arbitrare të policisë bashkiake të Tiranës kundrejt anëtarëve të komunitetit rom-egjiptian, në kuadër të sekuestrimit të mjeteve motorike të paregjistruara që shërbejnë si mjet transporti për transportimin e mbetjeve urbane të riciklueshme, kanë vijuar edhe përgjatë vitit 2017. KShH është duke përfaqësuar në gjykatë rastet e disa prej këtyre shtetasve të cilët pretendojnë se janë dhunuar fizikisht dhe psikologjikisht për motive raciale nga këta punonjës.

Në sajë të mbështetjes financiare të Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Shqipëri, KShH kreu një monitorim profesional në pikat e kalimit kufitar dhe institucione të tjera të trajtimit të azilkërkuesve dhe refugjatëve në Shqipëri, evidentoi mangësi infrastrukturore dhe organizative të institucioneve përgjegjëse për garantimin e plotë të të drejtave dhe trajtimin human të të huajve në përputhje me standardet ndërkombëtare. Pavarësisht disa përmirësimeve infrastrukturore në Qendrën e mbyllur për të huajt në Kareç, apo në disa pika të Kalimit Kufitar, si dhe plotësimit të legjislacionit me aktet nënligjore të nevojshme, KShH vlerëson se kapacitetet pritëse dhe akomoduese janë të limituara, çka bën që të mos jemi plotësisht të përgatitur para një shtate eventuale fluksi të emigrantëve nga vendet e lindjes.

Shtimi i numrit të specialistëve të përzgjedhjes dhe rritja e profesionalizmit të tyre, marrja e masave efektive për prezencën e përkthyesve, psikologëve apo punonjësve social në këto procedura, zbutja e masave ndëshkuese ndaj migrimit të parregullt, përmirësimi i ofritit të shërbimeve ligjore ndaj të huajve të pa dokumentuar, institucionalizimi i bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve shtetërore për mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijëve dhe mbrojtjes së familjes, si dhe zbatimi më i mirë i së drejtës ndërkombëtare në fushën e migracionit janë disa nga nevojat e identifikuara nga monitorimi i KShH-së.

Studimi i realizuar nga KShH për vendimet e gjykatave vendase për emigrantët që kalojnë pikat e Kalim Kufirit në Shqipëri (2012-2017), evidenton se janë dënuar me burg në kundërshtim me

standardet ndërkombëtare, duke i dhënë prioritet Kodit tonë Penal të huajt që kanë hyrë në mënyrë të parregullt, përfshirë edhe shtetasit sirianë, të cilët janë larguar nga vendi i tyre për shkak të luftës.

Në kushtet e dinamikave të reja të migrimit *nga* dhe *në* Shqipëri, është i nevojshëm hartimi i një strategjie shumëdimensionale për migracionin që të trajtojë, ndër të tjera, masat që duhet të merren ndaj shkaqeve të migrimit të parregullt. Aktualisht autoritetet kanë vendosur barrën kryesore për luftën ndaj migrimit të paligjshëm tek kontrolli efektiv i kufirit, por nevojitet një adresim i gjithanshëm dhe efikas i shkaqeve të migrimit të parregullt, me qëllim që masat ndaj migrimit të parregullt të jenë të suksesshme.

Niveli i varfërisë, papunësia dhe mungesa e shpresës tek të rinjtë ka ndikuar në marrjen e inisiativave për tu larguar drejt vendeve të BE, shpesh duke u bërë pjesë e korridoreve të paligjshme të trafikimit. Anketimi i Barometrit të Ballkanit evidenton se 50% e shqiptarëve po marrin në konsideratë të largohen nga vendi, ndërkohë që sipas EUROSTAT në tremujorin e dytë të këtij viti 6,000 shqiptarë aplikuan rishtas për azil, duke u renditur të gjashtit pas vendeve të lindjes së mesme dhe atyre afrikane për numrin e lartë të azilkërkuesve.

1.7 Lufta ndaj ekstremizmit të dhunshëm, barazia dhe ndalimi i diskriminimit

Ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi i shoqërisë janë probleme që shqetësojnë mbarë njerëzimin, ndërkohë që Shqipëria cilësohet si një vend me rrezik mesatar në këtë drejtim.

Në sajë të mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian, KShH në bashkëpunim me tre organizata simotra në rajon dhe organizatën Together for Life ka ndërmarrë një fushatë ndërgjegjësuere dhe parandaluese për ekstremizmin dhe radikalizmin në vendin tonë. Fushatat e zhvilluara në qytete të ndryshme të vendit janë mirëpritur nga organizata lokale, mediat, nxënësit dhe studentët, si dhe nga opinioni i gjerë publik, duke treguar nevojën për promovimin e tolerancës dhe respektimit të dinjitetit njerëzor kundër veprimeve ekstremiste. Një rol të rëndësishëm në drejtim të parandalimit dhe koordinimit të institucioneve ligjzbatuese ka pasur Koordinatori Kombëtar kundër ekstremizmit të dhunshëm.

Përdorimi i lartë i hapësirës digjitale nga grupe ekstremiste shqipfolëse, për të rekrutuar kryesisht të rinjtë që përdorin rrjetet sociale, kërkon mbështetje të plotë në burime njerëzore dhe infrastrukturë të agjencive të specializuara ligj zbatuese në vend, si dhe marrjen e masave efikase për parandalimin dhe adresimin e këtij fenomeni.

Në mbrojtje të parimit të barazisë dhe ndalimit të diskriminimit, KShH ka vijuar të jetë aktiv duke vënë në lëvizje Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD-në), me kërkesa për konstatimin e diskriminimit në raste të evidentuara dhe vlerësuara gjatë veprimtarisë monitoruese.

Gjatë vitit 2017, KShH ka adresuar pranë KMD-së tre ankesa për hetim të specializuar administrativ. Për një nga rastet, KMD-ja ka konstatuar diskriminim ndaj pacientëve si pasojë e mungesës së ilaçeve në pavijonin e Hematologjisë pranë QSUT. Rasti i dytë është në proces shqyrtimi ku është referuar diskriminimi i disa banorëve që janë në kushte të vështira social-ekonomike dhe nuk kanë akses në përfitimin e shërbimeve publike në Bashkinë Lezhë. Për çështjen e tretë, KShH ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të KMD-së në gjykatë, pasi

nuk është pranuar kërkesa jonë për diskriminimin e të dënuarve që nuk shpërblehen me tarifa të papërfillshme dhe me praktika të paunifikuara në sistemin e burgjeve.

Pavarësisht rolit të rëndësishëm të KMD-së në evidentimin e rasteve të diskriminimit, KShH ka ndjekur drejtpërdrejt rrugën gjyqësore me qëllim konstatimin e diskriminimit ndaj shtetasve të komunitetit rome-egjiptianë nga Bashkia Tiranë dhe qeveria shqiptare, për shkak të mbledhjes së mbetjeve të riciklueshme si mënyra e vetme e sigurimit të jetesës së përditshme të tyre dhe mungesës së përcaktimit të minimumit jetik me akte ligjore apo nënligjore. Çështja është në proces gjykim.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë vijon shqyrtimin e çështjes, vënë në lëvizje nga KShH, me objekt konstatimin e diskriminimit ndaj personave me aftësi të kufizuara, konkretisht pacientëve të mitur që nuk mund të dëgjojnë, për shkak të mungesës së ofrimit të pajisjes mjekësore *Implanti Koklear*.

Pavarësisht miratimit të Planit të Veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2016 – 2020, KShH vlerëson se mbetet ende për të përafruar legjislacionin e brendshëm me standardet e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, veçanërisht sa i takon kapacitetin ligjor për realizimin e veprimeve juridike. Gjithashtu, Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv (kombëtar dhe lokal) duhet të përparojnë në garantimin e përdorimit të gjuhës së shenjave për persona me aftësi të kufizuara në dëgjim, në përmbushje të detyrimit të parashikuar në Ligji Nr. 97/2013 *“Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*.

KShH përshëndet miratimin e ligjit të ri për mbrojtjen e minoriteteve, i hartuar në përputhje me Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve. Tashmë nevojiten masa konkrete dhe efikase në drejtim të zbatimit të tij, për përmirësimin e kushteve të jetesës, punësimit, arsimit, strehimit dhe integritetit në shoqëri, veçanërisht të anëtarëve të Komunitetit Rom dhe Egjiptian.

Në fushën e të drejtave të personave Lesbike, Gej (homoseksual), Biseksualë, Transgjjinor dhe Intersex apo “hermaphrodite” (LGBTI), KShH ka zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuere me anë të paraqitjes së një seti fotografik ndërkombëtar, ku promovohet barazia dhe lufta ndaj diskriminimit. Forumet e zhvilluara nga KShH me të rinjtë e universiteteve në ambientet e kësaj ekspozite, evidentuan nevojën për nisma të mëtejshme ndërgjegjësuere të publikut, pasi stigmatizimi ndaj komunitetit është i lartë dhe pranimi i tyre në shoqëri vijon të mbetet në nivele të ulëta. Gjatë vitit 2017, KShH ka trajtuar ankesën e një anëtar të këtij komuniteti ndaj disa punonjësve të policisë së Tiranës, për shkak të mosveprimit të tyre në mbrojtje të sigurisë personale të ankuesit ndaj agresionit të disa shtetasve për shkak të orientimit seksual të tij.

KShH ka reaguar publikisht, nëpërmjet deklaratave për shtyp edhe ndaj situatës shqetësuese të dhunës fizike dhe psikologjike ndaj të miturve në sistemin arsimor parauniversitar¹², mbrojtjen e nxënësve nga përdorimi i lëndëve narkotike në ambientet e institucioneve arsimore¹³, si dhe ndaj problematikës së hershme të ngujimit të fëmijëve për shkak të fenomenit primitiv të gjakmarrjes¹⁴.

¹²<http://www.ahc.org.al/shqetesuesc-situata-e-dhunes-psikologjike-dhe-fizike-ndaj-femijeve-ne-sistemin-arsimor-parauniversitar/>

¹³<http://www.ahc.org.al/te-mbrohen-nxenesit-e-shkollave-dhe-te-rinjte-nga-helmimi-i-lendeve-narkotike/>

¹⁴<http://www.ahc.org.al/te-ngujuarit-sidomos-femijet-kerkojne-nderhyrjen-e-shtetit/>

Miratimi dhe hyrja në fuqi të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur përbën një hap pozitiv në drejtim të vendosjes së standardeve cilësore lidhur me përgjegjësinë penale dhe masave që synojnë të shmangin të miturit në konflikt me ligjin nga privimi i lirisë. Sfidë për vendin mbetet zbatimi efektiv i legjislacionit të ri të miratuar për mbrojtjen e fëmijëve, duke kërkuar planifikim, buxhetin dhe kapacitete më të shumta në funksion të ri-edukimit efektiv të të miturve në konflikt me ligjin dhe mbrojtjen nga e tyre ngari-viktimizimi dhe recidivizmi.

1.8 E drejta për t'u konsultuar dhe informuar

KShH ka dhënë kontribut modest dhe të orientuar drejt cilësisë për përmirësimin e akteve të ndryshme ligjore që janë hartuar gjatë vitit 2017, nga ekzekutivi dhe legjislativi. Vlen të përmendet kontributi i dhënë nëpërmjet opionencës ligjore për një pjesë të paketës ligjore të reformës në drejtësi¹⁵ si dhe akte të ndryshme ligjore dhe nënligjore që prekin të drejtat dhe liritë e shtetasve.

KShH ka qenë aktiv në pasqyrimin e situatës së respektimit të të drejtave në vend, duke informuar organizata ndërkombëtare, si Delegacioni i BE-së në Shqipëri, Ambasadat e akredituara në Shqipëri, Komitetin për Parandalimin e Torturës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB) apo Komisionit European Kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), etj.

Në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, KShH monitoroi gjatë periudhës Korrik 2016 – Maj 2017, zbatimin e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik nga institucionet qendrore të ekzekutivit. Në tërësi, u vërejt se ligji është zbatuar në nivele të ulëta nga këto institucione. Procesi i konsultimit publik mbetet në nivele të pakënaqshme dhe përgjithësisht ka nota formalizmi. Në të shumtën e rasteve, institucionet e ekzekutivit kanë anashkaluar kërkesat që dikton ligji për respektimin e afateve dhe procedurave të kërkuara për konsultimin publik, duke cenuar parimin e transparencës dhe të qeverisjes së hapur. Vërehet gjithashtu mungesë besimi i vetë grupeve të interesit në procesin e konsultimit publik dhe tek institucionet që e realizojnë atë, duke pasjellë aktivizim relativisht të ulët të përfaqësuesve të këtyre grupeve për të dhënë sugjerime cilësore në proceset vendimmarrëse.

Në funksion të këtij monitorimi, KShH paraqiti për një pjesë të këtyre institucioneve ankime tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili konstatoi në 13 raste shkelje të së drejtës së informimit në dhënien e informacionit të kërkuar nga KShH për zbatimin e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik. Në dy raste Komisioneri konstatoi shkelje të së drejtës për njoftim dhe konsultim publik ndaj dy Ministrive, për ankesat e përcjella nga KShH për projektligjin e amnistisë dhe atë të strehimit social.

Gjatë 2017, rreth 5 % e ankesave drejtuar KShH-së kishte të bënte me shkeljen e të drejtës për t'u informuar, përkatësisht për mosdhënie përgjigje për kërkesë-ankesat e të dënuarve nga institucionet penitenciare, mungesë informacioni nga administrata e burgjeve për amnistinë/faljen, apo mungesë informacioni nga gjykatat apo nga prokuroria, etj.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka dhënë kontribut të rëndësishëm për respektimin e së drejtës për t'u informuar, duke konstatuar shkelje të kësaj të drejte themelore dhe duke urdhëruar organet publike si ILDKPKI dhe DSIK¹⁶

¹⁵ Ndryshimet në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, Ligjin për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve, Ligjin për përgjimin e komunikimeve elektronike, Ligjin për Parandalimin e Krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave ndaluese kundër pasurisë, Ligjin për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, etj.

¹⁶ <http://www.ahc.org.al/dy-organet-ndihmese-te-vettingut-detyrohen-te-bejne-transparence-te-plote-pas-ankimimit-te-kshh-se-tek-komisioneri-per-te-drejte-e-informimit/>

për kryerjen e transparencës mbi procesin ndihmës të vettingut. Megjithatë, mbetet nevoja e respektimit më të mirë nga ana e Komisionerit të afateve ligjore për zhvillimin e hetimit administrativ, marrjen e vendimit dhe zbatimin e tyre nga organet e administratës publike.

1.9 Mbrojta e mjedisit

Shfrytëzimi i inerteve të lumenjve, hedhja e mbetjeve urbane, ndërtimi buzë ujërave natyrore si lumenj e liqene, lëshimi i gazrave ndotës në ajër si pasojë e veprimtarive industriale në kundërshtim me standardet ligjore, djegia e mbetjeve të grumbulluara pranë zonave të banuara, si dhe prania e agjentëve ndotës në pusët e përdorura për ujë të pijshëm, vijnë të shkaktojnë dëme të konsiderueshme në mjedis dhe rrezikojnë shëndetin e njerëzve.

Organet e qeverisjes vendore vijnë të përballen me pamjaftueshmëri të fondeve për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane, çka në disa raste kemi vërejtur se ka shkaktuar ndotje të konsiderueshme të hapësirave publike e sidomos shtretërve të lumenjve.

Gjatë 2017-ës, KShH ka realizuar disa monitorime për ndotjen mjedisore mbi bazën e të cilave ka ndërhyrë në rrugë administrative dhe ka ndjekur në rrugë gjyqësore një pjesë të këtyre çështjeve. Për të sensibilizuar mbarë opinionin publik janë organizuar edhe tubime paqësore, në prezencë të medias, sikurse është rasti i banorëve të Visokës që nuk kanë ujë dhe një pjesë konsumojnë ujin e ndotur të puseve.

Duke marrë shkas nga media investigative, KShH ka verifikuar dhe ka konstatuar gjatë 2017-ës, ndotjen e shkaktuar nga aktiviteti i furrave gëlqerore të cilat kanë dëmtuar mjedisin dhe kanë vënë në rrezik serioz jetën dhe shëndetin e banorëve, në Bashkinë e Krujës. KShH po përfaqëson disa prej banorëve të prekur nga aktiviteti i furrave në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt, detyrimin e Bashkisë Krujë, për marrjen masave efektive për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja e shkaktuar nga këto furra.

Për shkak të gjendjes alarmante dhe vijueshmërisë së kësaj problematike prej disa vitesh, KShH ka realizuar një studim mbi vendimet e Prokurorisë dhe Gjykatës së Rrethit gjyqësor Krujë, për hetimin dhe gjykimin e veprës penale “Ndotja e ajrit”, të shkaktuar nga veprimtaritë e paligjshme të djegies së furrave gëlqerore, në periudhën Janar 2015 - Mars 2017. Studimi, ndër të tjera evidentoi pandëshkueshmërinë e krimit mjedisor në rastin e furrave gëlqerore por edhe në ato raste kur është ndëshkuar, nuk ka bërë të mundur parandalimin e përgjithshëm të veprës penale të lidhur me këto aktivitete. Në asnjë prej vendimeve të prokurorisë apo të gjykatës që i janë vënë në dispozicion KShH-së nuk rezulton që Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, Durrës apo Bashkia e Krujës të kenë denoncuar ndërhyrjet negative të kryera nga shtetasit apo subjektet e ndryshme të cilat kanë dëmtuar mjedisin. Gjetjet shqetësuese dhe rekomandimet në këtë studim për veprimtarinë e furrave gëlqerore, janë pasuar me një reagim të menjëhershëm të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Vetëm një javë¹⁷ pasi Komiteti i përcolli konkluzionet e studimit në këtë ministri dhe në një sërë institucionesh të linjës dhe organin e akuzës, nisi aksioni për mbylljen e furrave gëlqerore në Krujë. KShH do vijojë të monitorojë ndjekjen e kësaj çështje, duke ushtruar mjetet ligjore në mbrojtje të jetës dhe shëndetit të banorëve.

Problematika lidhur me grumbullimin dhe djegien e mbetjeve urbane pranë lumit Tërkuzë, Bashkia Kamëz është pjesë e procesit gjyqësor të vënë në lëvizje nga KShH, si një organizatë me interes legjitim për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të shtetasve. Ky proces gjyqësor synon të

¹⁷ Në muajin Shkurt 2018.

nxisë përgjegjshmërinë dhe reagimin konform legjislacionit në fuqi, në rastet e ndotjes mjedisore me pasoja aktuale apo potenciale në jetën dhe shëndetin e shtetasve.

KShH është duke ndjekur fillimisht në rrugë administrative problematikën e identifikuar nga dy gazetarë të PSE-së, pranë Laboratorit të Gazetarisë Investigative "Nafta në Shqipëri, historia e një krimi të pandëshkuar". Rezultatet e investigimit janë paraqitje e analizave laboratorike të realizuara në Greqi për 8 mostra (kampionëve) të naftës, ku 5 prej tyre janë marrë në zona të ndryshme të vendit tonë, përkatësisht në Tiranë, Elbasan, Shkodër dhe Korçë. Mostrat u ekzaminuan në laboratorin shkencor NAIAS në Pire të Greqisë¹⁸. Analizat evidentuan se nga pesë mostrat e naftës të marra në Shqipëri, një prej tyre rezultoi me nivelin e cilësisë 4, një me nivelin 2, një tjetër me nivelin 1 të cilësisë dhe dy mostra rezultuan me nivel cilësie 0. Katër prej pesë mostrave shqiptare të naftës u gjetën tepër problematike sa i përket përbërjes së tyre. Sasia tepër e lartë e squfurit në mostrat e marra, siç rezulton nga investigimi, vë në rrezik shëndetin dhe jetën e shtetasve që jetojnë në vendin tonë, duke prekur të drejtën më themelore të individit, atë të jetës.

¹⁸Për t'u analizuar objektivist më pas nga një inxhinier me eksperiencë në fushën e hidrokarbureve, i cili përdori për to shkallën e vlerësimit nga 0 deri në 5 (yje), ku zero ishte cilësia më e ulët e gjetur dhe pesë ajo më e larta.

